

FJALA E PRESIDENTIT
Eventi:

Biznesi, klima, këshilla ligjore: Si ta « prekim » Francën më nga afër ?

27/05/2021 ; 11h00-12h15, Zoom

Të nderuar anëtarë dhe pjesëmarrës,

Të nderuar Gjergji Themeli dhe Klit Delilaj,

Para së gjithash mirëseerdhët në këtë takim dhe shpresoj se ju dhe familjaret tuaj jeni të gjithë mirë!

Të flasësh për Francën nuk është kurrë e tepërt. Siç e thotë edhe **Charles de Gaulle: "Franca nuk mund të jetë Francë pa madhështi."**

Ju do të dëgjoni dhe do të mund t'i drejtoni pyetjet tuaja dy folësve tanë; Edhe unë dua te them disa fjalë përse duhet t'i dërgoni fëmijët tuaj të studiojnë ose jetojnë në Francë, të bashkëpunoni apo të hapin degën tuaj në Francë, etj.

❖ **Së pari, Përse të studiosh dhe të jetosh në Francë:**

- Franca i kushton gati **20% të buxhetit të saj kombëtar arsimit çdo vit**. Kjo përfaqëson rreth 10,000 Euro për student në vit
- Franca ka një trashëgimi të jashtëzakonshme dhe një jetë dinamike kulturore. Në fakt, trashëgimia e saj **përbëhet nga 41 zona kulturore të klasifikuara si Trashëgimi Botërore nga UNESCO**.
- Franca është gjithashtu e njohur **për gastronominë dhe e klasifikuar që nga viti 2010 si një trashëgimi botërore e paprekshme nga UNESCO**.
- E kufizuar nga 9 vende, Franca **është e vendosur në mënyrë ideale për të vizituar lehtësisht qytetet kryesore Evropiane** (Londër, Amsterdam, Gjenevë, Milano, Dublin, Berlin, etj.)

❖ **Përse të investosh në Francë?**

- Franca është një nga fuqitë më të mëdhaja botërore
- Franca ka një treg prej **65 milion konsumatorësh**. Për më tepër, Franca ka qasje në tregun e vetëm të Bashkimit Evropian, i cili ka më shumë se 500 milion konsumatorë.

- **Ka infrastrukturë transporti efikase dhe të zhvilluar mirë** - Franca është shtëpia e rrjetit më të madh rrugor në Evropë dhe rrjetit të dytë më të madh hekurudhor me shpejtësi të lartë në Evropë
- **Franca është një destinacion popullor.** Franca është destinacioni kryesor në botë për konferenca biznesi, destinacioni kryesor në botë për turistët dhe i treti për studentët
- **Franca është një lider në administratën elektronike** - Në këtë drejtim, Franca renditet e 4-ta për sa i përket infrastrukturës së telekomunikacionit, nivelit të arsimit të popullsisë dhe shërbimeve online të ofruara nga qeveria

Këto janë komentet e mia përse të zgjidhni Francën. Dhoma po mobilizohet masivisht në shërbim të bizneseve, anëtarëve natyrisht, por edhe bizneseve në Francë. Unë personalisht ofroj ndihmën time; nëse doni të investoni ose jetoni në Francë, mos hezitoni të më kontaktoni mua drejtpërdrejtë. Për sa i përket anës ligjore, « Cabinet d'avocats Klit Delilaj » do t'ju përgjigjet pas pak.

Ne jemi të bindur se falë punës së Dhomës dhe anëtarëve tanë, Ambasadës Franceze dhe institucioneve të tjera, shumë kompani franceze do të investojnë edhe në Shqipëri

Në qershor, do të kemi kënaqësinë të mirëpresim në Shqipëri një grup gazetarësh të shoqëruar nga Berenger Thibaut, anetari yne, e do të shkruajnë artikuj ekonomike për Shqipërinë:

- Luc Lagun - Bouchet France 3 për emisionin: **Citoyens européens**
- Marie Charel për gazetën: **Le Monde**

Unë ju uroj punë të mbare ne vijim dhe falenderoj shume për kohën e tyre **Gjergji Themeli dhe Klit Delilaj**.

Tani i'a jap fjalën Blerinës,

Faleminderit.

**Julien Roche
President**